



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17, pika o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008 , Ligjit nr.04/L-071 për sistemin e adresave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.29 e datës 27 dhjetor 2011, nenit 9 shkronja o) dhe nenit 20 par. 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.03.2026 pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

#### VENDIM

### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE TË REJA, SHESHEVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT**

I. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për emërtimin e rrugëve të reja (të pa emërtuara) , shesheve dhe hapësirave publike.

II. Komisioni formohet në në përbërje si vijon:

1. Imri Semetishti, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kryesues
2. Burim Rrustemi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtar
3. Nexhmedin Lekiqi, anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK
4. Gentianë Hoxhaj Gashi, anëtare e kuvendit nga subjekti politik LDK,
5. Xheneta Isufi, anëtare e kuvendit nga subjekti politik PDK,
6. Valenton Amrllahi, anëtar i kuvendit nga subjekti politik LVV,
7. Kryetari/a e fshatit, lagjes urbane përkatëse në të cilin emërtohen rrugët , anëtar/e;
8. Jetmir Bytyqi, zyrtar në Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar .

II. Detyrë e Komisionit është që të bëjë identifikimin dhe të propozoj emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike. Për kryerjen e këtyre detyrave, Komisioni konsultohet me këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane përkatëse.

III. Komisioni pas përfundimit të punëve, do të hartojë Propozim-Vendimin për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.

IV. Propozim Vendimi i hartuar nga Komisioni do të kalojë përmes Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

VI. Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për takimet e mbajtura do të kompensohen konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

VII. Afati kohor për përfundimin e punëve është 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

VIII. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

IX. Vendimi u dërgohet kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit.

X. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi nr.15-020/04-40406 i datës 28.07.2022 për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Lipjanit.

Nr. 15-020/04-13691

Lipjan, më 24.03.2026

## KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi



*Daut Azemi*